

2843
DT 12-06-2024



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
PREFEKTI I QARKUT ELBASAN
SEKTORI I ZHVILLIMIT URBAN

Nr. 032/prot.

Elbasan, më 10.6.2024

Lënda: Konfirmim akti

KËSHILLIT BASHKIAK LIBRAZHD

Në zbatim të nenit 16 të Ligjit Nr.107/2016 dt.27.10.2016 “Për Prefektin e Qarkut”, pasi u verifikua ligjshmëria e aktit tuaj Nr.50 datë 28.05.2024 “Për një ndryshim dhe shtesë të VKB-së nr.78 datë 10.06.2019 “Për miratimin e vend-depozitimit të mbetjeve inerte, në Bashkinë Librazhd”, konfirmojmë në parim, mbështetjen e tij në ligj.

PREFEKTI

NË MUNGESË DHE ME URDHËR

NËNPREFEKTI

Albert Ceci





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBRAZHD
KËSHILLI BASHKIAK

VENDIM

Datë.31.05.2024

Nr. 638 prot

Nr.50 dt.28.05.2024

**PËR NJË NDRYSHIM DHE SHITESËTË VKB-SË NR. 78 dt.10. 06 .2019“PËR
MIRATIMIN E VEND-DEPOZITIMIT TË MBETJEVE INERTE, NË BASHKINË
LIBRAZHD”**

Në zbatim të Ligjit Nr. 139/2015, datë 17.12.2015 “Për Vetqeverisjen Vendore”, Ligjit nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, Këshilli Bashkiak i mbledhur sot më datë 28.05.2024 dhe me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd.

VENDOSI:

1. Të shtojë si pikëvend-depozitimi të **përkohshme** të mbetjeve inerte, kryesisht dherave të gjeneruara nga gërmimet, në Bashkinë Librazhd, në lagjen ish- Ndërmarrja Shtetërore e Ndërtimit, sipas palvendosjes bashkëngjitur.
2. Ky vendim i përkohshëm, do të ketë fuqi deri nërilevimin, sistemimin dhe mbushjen e sipërfaqes së propozuar, në kuadër të realizimit të projektit “Ndërtimi i 2 fushave të futbollit”.
3. Ngarkohet Drejtoria e Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit, Projekteve dhe Investimeve, Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit, Drejtoria e Puneve Publike dhe Policia Bashkiake për zbatimin e këtij vendimi.
4. Ky vendim hyn në fuqi 10 ditë pas shpalljes.

SEKRETAR I KËSHILLIT
Elson MALLUTA

KRYETARI I KËSHILLIT
Mitat BICAKU





REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBRAZHD
RELACION**

PËR PROJEKT -VENDIMIN

Për një ndryshim dhe shtesë të VKB-së Nr. 78 Dt.10. 06 .2019 “Për miratimin e vend-depozitimit të mbetjeve inerte, në Bashkinë Librazhd”

Të nderuar këshilltarë,

Mbështetur në Ligjin nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore” të ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 10463, datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, me propozim të Kryetarit të Bashkisë Librazhd, në bashkëpunim mes Drejtorisë së Planifikimit dhe Zhvillimit të Territorit dhe Projekteve, Inspektoriatit të Mbrojtjes së Territorit, Drejtorisë së Punëve Publike dhe Policisë Bashkiake, I parashtrajmë Këshillit Bashkiak kërkesën për të bërë ndryshime dhe shtesa në VKB-në Nr. 78 Dt.10. 06 .2019 “Për miratimin e vend-depozitimit të mbetjeve inerte, në Bashkinë Librazhd”.

Ndryshimi që propozojmë është të shtojmë si pikë vend-depozitimi **të përkohshme** të mbetjeve inerte të gjeneruara kryesisht nga gërmimet e dherave nga projekte të ndryshme, zhavorreve dhe materialeve të krijuara nga zhvillimi i projekteve ndërtimore, duke i depozituar në lagjen ish-NSHN-ja (Ndërmarrja Shtetërore e Ndërtimit), sipas planvendosjes bashkëlidhur projekt vendimit.

Theksojmë që ky vendim është i përkohshëm dhe do të jetë i vlefshëm deri në rilevimin e plotë të sipërfaqes së propozuar për ndërtimin e projektit “Ndërtimi i 2 fushave të futbollit”, një projekt i fituar nga ana e bashkisë tonë nga aplikimi i bërë pranë Fondit Shqiptar të Zhvillimit.

Aktualisht ky institucion është duke kryer investime infrastrukturore, në kuadër të projektit “100 fushat”, nga i cili bashkia jonë bëri kërkesën dhe litoi projektin për ndërtimin e 2 fushave me tapet artificial. Fushat e propozuara do të ofrojnë një ambient të përshtatshëm për realizimin e aktiviteteve sportive, si dhe do të sigurojnë një hapësirë më të gjerë dhe më të përshtatshme për zhvillimin e kësaj disipline sportive, duke sjellë përfitime të mëdha për komunitetin lokal.

Ky projekt do të zhvillohet në pasurinë e ndodhur në zonën kadastrale 2446, pasuri në pronësi të Bashkisë, e cila aktualisht ka nevojë për mbushje, sistemim dhe rilevim, në mënyrë që të jetë e

përshtatshme për realizimin e projektit. Depozitimi në këtë sipërfaqe do të ndikojë shumë pozitivisht dhe do të reduktonte shumë kostot për realizimin e projektit, duke shkurtuar shumë dhe kohën e realizimit të tij.

Konceptoi: Znj. Artanca Gjura.

Pranoi: Z. Enri Gjura